# PROGRAM ORIENTUES
# PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
# TË MATURËS SHTETËRORE

## PËR ARSIMIN E MESËM

## NË LËNDËN:

## HISTORI

VITI MËSIMOR     2008-2009

**Tiranë, 2009**

# Udhëzime për zbatimin e programit

Programi orientues për lëndën me zgjedhje histori, përfshin koncepte më të rëndësishme të historisë, si dhe njohuritë dhe shprehitë themelore që i duhen nxënësit në këtë disiplinë. Ky program është bazuar në programet ekzistuese të historisë së shkollës së mesme të përgjithshme. Programi orientues për provimin me zgjedhje të historisë, në kuadrin e maturës shtetërore për vitin shkollor 2008-2009, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme të përgjithshme, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimet e maturës shtetërore.

- Programi përmban dhe siguron informacionin e nevojshëm për mësuesit e historisë të shkollave të mesme të përgjithshme që do të përgatisin maturantët për provimin e historisë si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.

- Programi orienton nxënësit për materialet kyç mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e historisë si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të të interesuarve, kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit duhet të përmbajnë njohuri dhe koncepte të trajtuara në tekstet e historisë së shkollës së mesme.

Mësuesit që do përgatitin nxënësit për provimin e historisë duhet t'i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehitë e përcaktuara në këtë program, por duhet të trajtojnë dhe çështje që nuk parashikohen në program, por përmbajnë informacion të rëndësishëm për të përvetësuar materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e historisë, duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve historike dhe shprehive të përcaktuara në program.

**Histori ( 174 orë )**

**Lista e koncepteve historike që duhet të përmbajë testi**

| Nr | Periudha historike | Konceptet kryesore |
|---|---|---|
| 1 | **Historia 1**<br><br>**Historia e Lashtë Botërore** | Kodi i Hamurabit; kuneiform; mbretëria e vjetër egjiptiane; fazat e organizimit të saj; para lindjes së krishtit; pas lindjes së krishtit; nome; hieroglife; kultura e Kretës; kultura e Mikenës; demos; aristokraci; polis; bazile; ligje drakoniane; eklesia; oligarki; aeropag; institucionalizëm i përzier; republika romake; etrusk; plebe; patrice; konsull; pretor; triumvirat; principat; kolonat; lidhja e Peloponezit; perandori romake; federatë; krishtërim; falanga maqedonase; epoka helenike; despotizëm etj. |
| 2 | **Historia 1**<br>**Historia Botërore e mesjetës** | Perandoria Bizantine; periudha e Justinianit; vija e Teodosit; islamizëm; kalifat; babai i Europës; feudalizëm; vasal; senjor; sistem çifligar; çiflig vetërodhues; Magna Karta; monarki e kufizuar; monarki absolute; sistem kalorsiak; bujkrob; sheriat; kanunet; jeniçerë etj. |
| 3 | **Historia 2**<br><br>**Historia moderne Botërore** | Reformacion; protestianizëm; puritanë; kalvinizëm; kundërreformë; koncili i Trentos; jezuitë; e drejta hyjnore; merkantilizëm; Elisabeta I; Pjetri i madh; puritanët; presbiterianët; indipendëntë; parlamenti i gjatë; lord protektor; revolucion i lavdishëm; revolucion industrial; “laissez-faire”; sipërmarrje e lirë; iluminizëm; konfederatë; “liri, barazi, vëllazërim”; jakobinë; regjim i terrorit; direktorat; epoka e Napoleonit; zhirondin; legjitimitet absolutist; konservatorizëm; liberalizëm; radikale; nacionalizëm modern; Garibaldi; zollverein; nacionalverein; Bismark; ligji mbi homstedin; demokraci liberale; imperializëm; nacionalizëm i skajshëm; militarizëm etj. |
| 4 | **Historia 3**<br>**Profili Shoqëror**<br><br>**Historia Botërore e shekullit të XX** | Ultimatum; Plani Shlifen; Antanta; Blloku Qendror; Këshilli i të katërtëve; Lidhja e Kombeve; sistemi i traktateve të Versajës; gjykata ndërkombëtare e Hagës; “një klub kapitalist”; “ një klub fitimtarësh”; Kominterni; perandoritë e mëdha; revolucioni Bolshevik; mrekullia ekonomike; liberalizmi i hershëm; depresioni i madh; “trusti i trurit”; kursi i ri i Ruzveltit”; Administrata e Korpusit Civil të Mbrojtjes”; Ligji mbi Standardet e Ndershme të Punës”; Parti Laburiste Parti Konservatore; Republikë Parlamentare; Senat; Republikë Presidenciale; Kryqet luftarake; Aksioni Francez; Fronti Popullor; deklarata Bone’ -Ribentrop; carizmi; Revolucion Bolshevik; totalitarizëm komunist/fashist; Pushteti i Sovjetëve; Këshilli i Komisarëve të Popullit; Parti-shtet; ÇEKA; KGB; Ushtria e Kuqe; Ushtria e Bardhë; Terrori i Kuq; Politika e Komunizmit të luftës; NEP; Socializimi i njeriut; nacionalizëm i skajshëm;Republika e Vajmarit; Republika sovjetike e Bavarisë; Partia Nacional-Socialiste; Mein Kampf(Lufta ime); doktrina naziste; “një shtet, një popull, një udhëheqës”; kajzer; kancelar; Kolona e Pestë; qeverisje autoritare; kushtetuta e Vidovdanit; zhupani’; banovina; Antanta e Vogël; “regjimi i 4 gushtit”; “Asambleja e Madhe Kombëtare”; Anshlusi; pakti i Mynihut; “Plani i Bardhë”; luftë e çuditshme; Operacioni Barbarosa; Gjyqi i Nyrembergut; OKB; UNICEF; UNESKO; UNHCR; NATO; SEATO; SENTO; KEQÇ; KEE; KE; EKU; BE;SALT 1; SALT 2; KSBE; OSBE; Traktati i Varshavës; Lufta e Ftohtë; bllokada ekonomike; Muri i Berlinit; Perdja e Hekurt; Plani Marshall; liberalizmi modern; shteti i mirëqenies; Kejnsianizmi; ekspansionizmi sovjetik; proteksionizmi; Republika IV/V; Mrekullia ekonomike; Ostpolitika; Kursi i Trajtimit të Drejtë; makartizmi; ligji Taft Hartli; inflacion; ”Kursi i Kufijve të |

| | | |
|---|---|---|
| | | rinj"; medicare; mediaid; skandali i uotergeit; Theçerizmi; Reganizmi; neokonservatorizmi; neoliberalizmi; derregullimi; Akti Unik Evropian; Lufta e Klasave; udhëheqës totalitar; Destalinizmi; centralizim/decentralizim i ekonomisë; Gllasnosti; Perestrojka; grusht shteti; "mekanizmi i ri ekonomik"; komunizmi me fytyrë humane; sovranitet i kufizuar; Solidarnost; Karta 77; Muri i Berlinit; Presidenca Kolektive; diktatura ushtarake; Pakti i Stabilitetit; Bipolarizim; multipolarizim; Detanta; Lufta e Yjeve; Rendi i ri Botëror i Evropës; Doktrina Truman; NATO; etj. |
| **5** | **Historia 4 Profili Shoqëror**<br><br>**Historia e popullit shqiptar** | Ilir; epir; epirot; dardani; dardan; koloni helene**;** Urbanizim**;** federata fisnore; bazile; shtet skllavopronar; shtet feudal; republika epirote; lidhja e foinikës; thema; strateg; zhupa; dheu; prevali; epiri i vjetër; albanoi; kultura e komanit; dinate; megistanes; parikë; stratiotika; pronia; bashtina; synergasi; vllazni; nafta e mesjetës; patricati; popullorët; konti i qytetit; qyteti komunë; magistra të betuar; vojvoda; principatë; despotat; despot; sanxhak; vilajet; ejalet; kaza; nahije; koalicion; lidhja e Lezhës; traktati me Venedikun; traktati gaetës; shtet i përqendruar; këshilli i lartë; kuvendincave; këshilli i luftës; sheriat; kanuname; kararname; kodi i Shkodrës; esnafe; llonxha; qytykë; qytyku i Elbasanit; kodikë; kallfa; çiraku; mjeshtri; timar; ziamet; has; regjim feudal ushtarak; spahi; raja; çiflig;çifligar; çifçi; xhizja; xhelepi; akçe; krahinë autonome; venome; bajraktar; pashallëk; politikë autonomiste; vali; konfederata ilirike; divani; akademia e re; arabeska; tyrbe; mesxhide; mektepe; medrese; tyrbe; teqe; rilindje; tanzimat; principata autonome e mirditës; lidhja kombëtare shqiptare; naçertania; megali ide; evëtori; kriza lindore; traktati i Budapestit; traktati i Shën Stefanit; kongresi i Berlinit; rumeli; komiteti i Stambollit; lidhja e Prizrenit; "kushtetuta e lidhjes"; kararname; talimati; punë botore; komiteti kombëtar i lidhjes së Prizrenit; memorandum; alfabeti i Stambollit; shoqëria e të shtypurit shkronja shqip; shoqëria e mësimit shqip; mësonjëtorja kombëtare; lidhja e Pejës; normale; klube; xhonturk; përkujtesa e greçës; kuvendi i junikut; itilafistë; status-quo; lufta ballkanike; kanuni i përtashëm; kanuni i jurisë; principatë sovrane- autonome; KNK; lëvizje vorio-epirote; qeveri vorio-epirote; shovinizëm; statut organik; asambleja kombëtare; kapitulacione; krahina autonome e Korçës; traktati i fshehtë i Londrës; statuti i Lushnjes; këshilli kombëtar; këshilli i lartë; senati(si pleqësi dhe dhomë parlamenti); lëvizje esatiste; lufta e Vlorës; vija strategjike; republika e Mirditës; statuti i zgjeruar i Lushnjes; asamble kushtetuese; revolucioni i qershorit; legalitet; regjim legal; triumfi i legalitetit; SVEA; AIPA; pakti i 1-2 i Tiranës; këshilli i shtetit; reforma agrare; moratorium; kontrata tip; agresion fashist; regjimi i pushtimit; fronti Nacinal-Çlirimtar; balli kombëtar; dekalogu; çeta partizane; këshilla antifashiste; shtabi i përgjithshëm; komiteti për shpëtimin e Shqipërisë; mbledhja e Mukjes; misione aleate; KANÇ; lidhja e dytë e Prizrenit; konferenca e Bujanit; pluralizmi pronësor; sistem monopartiak; sistem totalitar; incidenti i Korfuzit; lufta e klasave; tufëzat; arëzat; emancipimi i gruas; integrim euroatlantik; genocid; UDB; shkombtarizim; |

**Lista e objektivave të njohurive që do të përmbajë testi**

- Të hartojë linjën e kohës ku ngjarjet, figurat, ndryshimet dhe zhvillimet historike të studiuara të vendosen brenda kufijve të caktuar kronologjikë.
- Të dallojë kohën dhe vend-formimin e mbretërisë së Egjiptit, fazat e organizimit të saj, Babiloninë, ligjet e Hamurapit, kulturën e vendeve të lindjes së Lashtë.
- Të identifikojë Greqinë e Lashtë, funksionet e këshillit të pleqve, kuvendit të qytetarëve, shkaqet e luftës së demosit me aristokracinë dhe rrjedhimet e saj.
- Të shpjegojë rolin e figurave historike si Soloni, Klisteni, Perikliu, dhe përmbajtjen e reformave të tyre.
- Të identifikojë kufizimet e demokracisë në Athinë, karakteristikat e çdo shtrese të popullsisë në Spartë, institucionet dhe qeverisjen e saj.
- Të evidentojë reformat demokratizuese të Perikliut.
- Të identifikojë kohën e formimit, figurat historike, fazat e organizimit të mbretërisë së Maqedonisë si dhe rrjedhimet e fushatave të Aleksandrit.
- Të dallojë kohën e formimit, shtrirjen dhe fazat e organizimit të Romës.
- Të tregojë reformat që janë kryer në Romën e Vjetër, shkaqet dhe rrjedhimet e luftës së plebejve me patricët.
- Të vlerësojë dhe analizojë tiparet kryesore të periudhës republikane duke evidentuar rolin e organeve qeverisëse dhe shkallën e të drejtave të popullsisë.
- Të identifikojë shkaqet e krizës së republikës romake.
- Të tregojë shkaqet e rënies së perandorisë romake, si dhe rrjedhimet ekonomike, shoqërore dhe politike.
- Të tregojë rrethanat e lindjes së Krishterimit dhe Islamizmit.
- Të dallojë kohën e formimit, shtrirjen dhe fazat e organizimit të perandorisë osmane.
- Të përshkruajë përmbajtjen e Kodit të Justinianit, kohën vendin dhe figurat historike të shtetit të Frankëve.
- Të tregojë shkaqet, kohën, shtrirjen dhe formimin e shtetit të Francës dhe Anglisë.
- Të përshkruajë përmbajtjen e "Kartës së Madhe të Lirive" dhe rëndësinë e saj.
- Të tregojë shkaqet e zbulimeve të mëdha gjeografike, si dhe rrjedhimet ekonomike, shoqërore dhe politike.
- Të analizojë parimet e doktrinës së Martin Luterit, Kalvinit dhe shkaqet e përhapjes në Gjermani.
- Të tregojë organizimin e shtetit anglez në kohën e mbretëreshës Elisabetë I Tudor, shkaqet dhe rrjedhojat e procesit të gardhimit si dhe krizës së regjimit të vjetër në Angli.
- Të tregojë shkaqet dhe rrjedhojat e luftës civile në Angli, Revolucionin e lavdishëm, si dhe përmbajtjen e "Deklaratës së të drejtave" e nënshkruar nga Vilhelmi.
- Të shpengojë përpjekjet e Pjetrit të Madh për Evropianizimin e Rusisë.
- Të identifikojë zbulimet teknike dhe rrjedhojat e revolucionit industrial.
- Të analizojë iluministët francezë, si dhe konceptin e tyre për shtetin.
- Të tregojë politikën e organizimit të shtetit në Francë në kohën e Luigjit XIV dhe Luigjit XV, të perandorisë Gjermane dhe rrjedhojat e Luftës për pavarësi në Amerikën e Veriut.

- Të evidentojë rolin e Napoleon Bonapartit si figurë historike, reformat e ndërmarra prej tij.
- Të analizojë organizimin politik të Anglisë në kohën e mbretëreshës Viktoria, të Gjermanisë në kohën e Bismarkut, e të Italisë së bashkuar.
- Të identifikojë parimet bazë të demokracisë liberale dhe përpjekjeve të nacionalizmit të skajshëm për t'ju kundërvënë këtyre lëvizjeve.
- Të përshkruajë ngjarjet kryesore botërore si luftën I, II Botërore, Konferencat dhe traktatet që sollën ndryshime të rëndësishme në hartën politike te botës dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, orientimet ekonomike dhe politike të shteteve, reformat e rëndësishme në Itali, Francë, Angli,Gjermani, SHBA, Spanjë, Jugosllavi në kohë të ndryshme, krijimin dhe misionin e organizmave botërore si Lidhja e kombeve, OKB, KE, BE, OSBE, NATO, Traktati i Varshavës, figurat dhe personalitetet kyçe te historisë botërore dhe të shteteve te veçanta që shënuan kthese ne zhvillimet e vendeve përkatëse apo rrjedhat botërore si Ëilson, Klemanso, Çurçill, Ruzvelt, Leon Blumi, Lenin, Stalin, Tito, Milosheviç, Musolin, Hitler, Franko, Huan Karlos, Hebert, Karagjeorgjeviç, Metaksa, Sharl De Gol, Zhan Mone, Etli, Adenauer, Regan, Kenedi, Klinton, Theçer etj.
- Të tregojë jetën politike, ekonomike dhe shoqërore në Angli, Gjermani Francë, Itali, SHBA në vitet 1919-1939 dhe pas Luftës II Botërore
- Të analizojë dhe konkludojë vendimet e Konferencës së Versajës, organizimin e Lidhjes së Kombeve , Konferencën e Munihut, e Teheranit/ Jaltës/ Potsdamit, Planin Marshall, Paktin e Stabilitetit dhe impaktin e tyre në zhvillimet rajonale apo botërore.
- Të identifikojë, krahasoje dhe analizoje lindjen, organizimin, reformat e shtetit fashist në Itali dhe atij nazist në Gjermani.
- Të përcaktojnë, krahasojnë dhe analizojnë shkaqet e brendshme e të jashtme që e çuan Botën në 2 Luftëra Botërore.
- Të analizojë, krahasojë politikat e jashtme e të brendshme, aleancat dhe marrëveshjet e shteteve shkaktare dhe pjesëmarrëse ne Luftën e Dytë Botërore, rrugën ekonomike politike të ndjekur nga Musolini , Hitleri për të sunduar botën dhe impaktet e luftërave mbi jetën ekonomike politike sociale të shteteve dhe botës në tërësi.
- Të krahasojë dhe të përcaktojë pikat e takimit dhe ndryshimet midis personazheve historike si Lenin, Musolini, Hitleri, Franko, Stalini, Metaksai, Milosheviç.
- Të krahasojnë regjimet totalitare të majta dhe të djathta dhe të nxjerrin përfundime.
- Të formulojë tendencat e reja të Botës pas Luftës Parë dhe të Dytë Botërore.
- Të identifikojë partitë politike dhe figurat politike më të suksesshme në Britani, Francë, Gjermani, Itali, SHBA
- Të flasin për rrugën e zhvillimeve ekonomike dhe politike në BS që nga Stalini, Hrushovi e deri tek Gorbaçovi.
- Te analizojnë impaktin e reformave Gorbaçov dhe zhvillimeve demokratike në Gjermani në jetën politike të Evropës Lindore.
- Të identifikojnë raste konkrete te pasojave të traktateve dhe veprimeve apo mosveprimeve të individëve apo qeverive në zhvillimet botërore .
- Të identifikojë tiparet e jetës ekonomike-politike ballkanike pas Luftës së Dytë Botërore dhe sfidat ballkanike në kuadrin shpërbërjes së ish Jugosllavisë dhe Paktit të Stabilitetit.

- Të krahasojë, analizojë, interpretojë tiparet e qeverisjes demokratike duke e krahasuar me atë totalitare.
- Të listojë në linjë kronologjike ngjarjet historike që sollën regres apo progres në zhvillimet botërore.
- Të ndërtojë kronologjinë e proceseve demokratike në botën e pas Luftës II Botërore.
- Të listojë tendencat e reja të botës së pas luftës II - të në krahasim me tendencat botës së pas Luftës - I .
- Të listojë etapat e shtetit në historinë e popullit shqiptar
- Te përcaktojë format e qeverisjes në shtetet Ilire dhe të selektojë si të veçantë formën republikane në Epir.
- Të dallojë dhe përcaktojë formën e qeverisjes në etapa të ndryshme të shtetit shqiptar.
- Të përcaktojë kohën e formimit, tiparet dhe raportet midis tyre tek institucionet në Shqipëri.
- Të vendosi raportet shkak pasojë për të gjitha ngjarjet historike.
- Të zotërojë datat më të rëndësishme historike si: kohën e formimit të shteteve, Lidhja e Lezhës, principatat, Pashallëqet, Lidhja e Prizrenit, Lidhja e Pejës, libri i parë Shqip, Shkolla e Pare Shqipe, Normalja e Pare, Alfabeti i Parë Shqip, Universiteti i Parë, Dokumenti i Parë Diplomatik për Shtetin Shqiptar, Shpallja e Pavarësisë, Konferenca e ambasadorëve Londër, Koha e Vidit, Revolucioni i Qershorit, Republika e Zogut, monarkia zogiste, lufta antifashiste, çlirimi i Shqipërisë, periudha komuniste, vendosja e pluralizmit etj.
- Të tregojë dhe interpretojë përmbajtjen e të gjitha traktateve që lidhen me historinë e Shqipërisë.
- Të shpjegojë konceptet baze, duke vendosur ngjarjen dhe kohën dhe vendin e duhur.
- Të lidhi datat, personazhet me ngjarjen dhe vendet përkatëse.
- Të përzgjedhë, përdori dhe të analizojë burimet alternative mbi origjinën dhe vazhdimësinë iliri-arbërore-shqiptare.
- Te përshkruajë dhe analizojë veprimtarinë dhe rolin e figurave dhe personazheve historike në zhvillimin e ngjarjeve historike, si Bardhyli, Agroni, Teuta, Dhimitër Fari, Genti, Pirro, Dhimitri i Arbërit, Teodor Ëngjëllori, Karl Topija, Balshajt, Muzakajt, Skënderbeut, Kara Mahmut Pashës, Ali Pashë Tepelenës, Zef Jubanit, Sami Frashërit, Abdyl Frashërit, Ymer Prizrenit, Haxhi Zekës, Gjergj Fishtës, Luigj Gurakuqit, Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Isa Boletinit, Isuf dhe Hodo Sokolit, Dedë Gjo Lulit, Ismail Qemalit, Vidit, Esat Pashë Toptanit, Turhan Pashë Përmetit, Sulejman Delvinëns, Nolit, Zogut, Enver Hoxhës, Ibrahim Rugova etj.
- Të dallojë pushtuesit e trevave shqiptare, kohën e pushtimeve dhe rrjedhojat e tyre në jetën ekonomike dhe politike të vendit..
- Të tregojnë tiparet e artit dhe kulturës shqiptare në periudha të ndryshme të historisë.
- Te përshkruajë arritjet e shqiptareve në epokën e Skënderbeun, duke evidentuar rëndësinë e kësaj epoke për Shqipërinë.
- Të dallojë elementet shtetërore ne principata, pashallëqe duke i krahasuar ato.
- Të tregojë e krahasojë simbolet, titujt e princave e pashallarëve në principata e pashallëqe të ndryshme.
- Të përcaktojë kufijtë e disa principatave më të rëndësishme dhe pashallëqeve duke përdorur hartat përkatëse

- Të analizojë programin e Rilindjes Kombëtare dhe të përcaktojë oshilacionet e tij drejt autonomisë dhe pavarësisë .
- Të listojë arritjet e lidhjes se Prizrenit për autonomi dhe për tërësinë e trojeve Shqiptare.
- Të përcaktojë formën e qeverisjes në etapa të ndryshme të shtetit Shqiptar.
- Të përcaktojë dhe analizoje kuadrin historik të ngjarjeve më të rëndësishme, si lidhja e Lezhës, lidhja e Prizrenit, traktati i Budapestit, kongresi i Berlinit, shpallja e Pavarsisë, konferenca e Londrës, qeverisja e Vidit, kongresi i Lushnjes, Lufta e Vlorës, Protokolli i Korfuzit, Protokolli i Kapshticës, Protokolli i Tiranës, vendosja e Republikës, monarkisë së Zogut, formimi i frontit, krijimi i partive dhe Ballit gjatë luftës, konferenca e Mukjes, kongresi i Përmetit, vendosja e regjimit komunist, rrëzimi i diktaturës.
- Të analizojë përmbajtjen e traktateve, memorandumeve, programeve të dala gjatë lëvizjes Kombëtare në Shqipëri.
- Të analizojë faktorët që sollën pushtimin fashist dhe tiparet e organizimin të rezistencës antifashiste të popullit shqiptar.
- Të dallojë reformat komuniste nga reformat kapitaliste.
- Të rendisë kronologjikisht protokollet, kushtetutat, parlamentet, në Shqipëri.
- Të krahasojë kushtetutat në Shqipëri duke argumentuar ndryshimet midis tyre.
- Të selektojë elementët progresive dhe regresive të kushtetutave në Shqipëri.
- Të identifikojë shkaqet, pasojat e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri.
- Të analizojë dhe listojë faktorët që sollën ndarjen e Kosovës dhe Çamërisë nga Shqipëria.
- Të përshkruajë, analizojë dhe inkuadroje ngjarjet në Shqipëri, zhvillimet ekonomike, politike, arsimore në Kosovë e Çamëri në periudha të ndryshme.
- Të tregojë politikat e ndjekura nga sërbët, malazezët dhe grekët ndaj shqiptarëve që banojnë në trojet e tyre, Kosovë, Mal të Zi dhe Çamëri duke analizuar impaktin e tyre mbi popullsinë.
- Të rendisë kronologjikisht përpjekjet e shqiptarëve në Kosovë për t’i shpëtuar procesit të sh’kombtarizimit dhe krijimit të institucioneve të tyre.

**Lista e objektivave të shprehive që duhet të përmbajë testi**

- Të identifikojë përkatësinë e elementeve kulturore të vendeve të Lindjes, Greqisë dhe Romës.
- Të përcaktojë kohën dhe kushtet e formimit të shteteve të Egjiptit, Babilonisë, Greqisë, Romës.
- Të krahasojë ligjet drakoniane, të Solonit, Klistenit dhe Perikliut.
- Të krahasojë funksionet e institucioneve shtetërore të kohës së Perikliut.
- Të identifikojë elementët e veçantë dhe të përbashkët të fesë së krishterë dhe islame.
- Të krahasojë shtetin e frankëve të Karlit të Madh me të Merovingëve dhe Karolingëve.
- Të krahasojë monarkitë Franceze me monarkitë Angleze.
- Të dallojë politikën e zhvilluar nga udhëheqës të shteteve të ndryshme.

- Të vlerësojë pikëpamjet fetare të puritanëve dhe katolikëve.
- Të vlerësojë pikëpamjet e Luterit, Cvinglit dhe Kalvinit.
- Të identifikojë mendimet e iluministëve francezë për organizimin e shtetit.
- Të krahasojë politikat e Luigjit XIV dhe Luigjit XV për organizimin e shtetit në Francë.
- Të interpretojë të dhënat e paraqitura në linjën kohore, me qëllim që të dallojë dhe të përcaktojë zhvillimet më të rëndësishme historike nga ato më pak të rëndësishme, që kanë ndodhur në një vend apo grup vendesh brenda të njëjtës periudhë historike.
- Të dallojë vendin përkatës duke analizuar politikën e zhvilluar nga udhëheqës të shteteve të ndryshme.
- Të identifikojë partitë politike dhe rolin e tyre në Francë, Angli, Gjermani, Itali dhe SHBA duke u nisur nga programi i tyre..
- Të dallojë të përbashkëtat dhe ndryshimet në mes sistemeve totalitare të majta dhe të djathta.
- Të argumentojë rrjedhojat e ngjarjeve historike në plan pozitiv apo negativ
- Të bëjë dallimin e sistemit totalitar komunist nga ai demokratik..
- Të identifikojë personalitete historike dhe politike në kohë dhe shtete të ndryshme.
- Të përcaktojnë sfidat Botërore, Evropiane, Ballkanike, Shqiptare sot.
- Të përdori njohuritë historike për të krahasuar shtetet që u formuan në Shqipëri sipas periudhave
- Të evidentojnë figurën e shtetit ne etapa te ndryshme te historisë se Shqipërisë duke përdorur njohuritë mbi modelet e mëparshme shtetërore.
- Të përcaktojnë formën e qeverisjes së shtetit në etapa të ndryshme të historisë së Shqipërisë.
- Të argumentojnë shkaqet dhe pasojat e një fenomeni historik.
- Të vendosin ngjarjen historike ose personazhin historik në kohën dhe vendin e duhur.
- Të ndërtojnë shkallën e kohës në një etapë të caktuar historike.
- Ti inkuadrojnë ngjarjet kombëtare me ato rajonale dhe evropiane.
- Të përcaktojnë konceptin e shtetit, monarkisë, republikës, kushtetutës, parlamentit në ngjarje të caktuara të historisë së Shqipërisë.
- Të përdori njohuritë e fituara e të krahasojë shtetin shqiptar si dhe shtetet evropiane para dhe pas Luftës së Dytë Botërore
- Të aftësohen që për aspekte të ndryshme të periudhave historike të përfshira në studim të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si dokumente historike, foto, harta historike etj.
- Të gjejnë dhe të hulumtojnë burimet kryesore historike të informacionit për ngjarje të ndryshme duke dalluar burimet primare nga ato dytësore.
- Të vlerësojnë në mënyrë kritike burimet e ndryshme të informacionit në kontekstin e tyre historik, të mbledhin të dhëna për një çështje të caktuar dhe të arrijnë në përfundimet përkatëse.
- Të formulojnë pyetje historike të bazuara mbi burime dokumentare primare dhe dytësore si foto, kujtime, ditare etj, për një problem të caktuar dhe t’i përgjigjen atyre.
- Te listojnë ne linje kronologjike ngjarjet me te rëndësishme të historisë si në tema, kapituj, lëndë.
- Të ndërtojnë shkallen e kohës për etapa, figura historike ose koncepte historike.
- Të përdorin hartën historike për ndërtimin e ngjarjeve historike dhe anasjelltas

- Të bëjnë punë me projekte, të përdorin historinë gojore, historinë lokale për thellimin e njohurive historike.
- Të ndërtojnë opinionet individuale mbi perspektivat e botës, rajonit, apo vendeve të veçanta.
- Të përgatisin ese, debate mediatike, video, kronika historike etj.

## SHPERNDARJA E PESHAVE SIPAS FUSHAVE

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1.** | **Historia e Lashtë Botërore** | **13 orë** | **7.5 %** |
| **2.** | **Historia Botërore e Mesjetës** | **8 orë** | **4.5 %** |
| **3.** | **Historia Moderne Botërore** | **22 orë** | **13 %** |
| **4.** | **Historia Botërore e Shekullit të XX** | **44 orë** | **25 %** |
| **5.** | **Historia e Popullit Shqiptar** | **87 orë** | **50 %** |
| | **Totali** | **174 orë** | **100%** |

## SHPERNDARJA E PESHAVE SIPAS LINJAVE

**Historia e Lashtë Botërore ( Historia 1 )**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Lindja e Mesme e Lashtë. | 2orë | 15 % |
| 2. | Greqia e Lashtë e Maqedonia. | 6 orë | 46 % |
| 3. | Roma e Lashtë | 5 orë | 39 % |
| | **Totali** | **13 orë** | **100%** |

**Historia Botërore e Mesjetës ( Historia 1 )**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Bota mesjetare | 4orë | 50% |
| 2. | Zhvillimi i monarkive në Evropë | 3orë | 38 % |
| 3. | Perandoria osmane | 1 ore | 12 % |
| | **Totali** | **8 orë** | **100%** |

**Historia Moderne Botërore ( Historia 2 )**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1.** | Shoqëria në fillimet e kohës moderne. | 4 orë | 18 % |
| **2.** | Konsolidimi i monarkive absolutiste. Fillimet e krizës në qeverisje. Vitet 1500 – 1789. | 4orë | 18 % |
| **3.** | Ndryshime në jetën ekonomike dhe sociale në shek. XVII – XVIII. | 1 orë | 5 % |
| **4.** | Idetë e reja dhe kombet e reja. | 5 orë | 23 % |
| **5.** | Reaksioni dhe progresi në vitet 1815 – 1850. | 2 orë | 9 % |
| **6.** | Nacionalizmi dhe konsolidimi i komb - shteteve. Epoka e nacionalizmit 1850 – 1871. | 3 orë | 13 % |
| **7.** | Fillimet e qeverisjes së demokracisë liberale. ne vitet 1871 – 1900. | 2 orë | 9 % |
| **8.** | Qytetërimi në pragun e shekullit të XX. | 1 orë | 5 % |
| | **Totali** | **22 orë** | **100%** |

**Historia Botërore e Shekullit të XX ( Historia 3. Profili Shoqëror )**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1.** | Thellimi i krizës së shek. XX. Lufta e Parë Botërore. | 1 orë | 2 % |
| **2.** | Traktatet e Paqes. Problemet e pazgjidhura. Prirjet e zhvillimit. | 3 orë | 7 % |
| **3.** | Demokracitë Perëndimore në vitet 1918 – 1938. | 4 orë | 9 % |
| **4.** | Totalitarizmi komunist e fashist. | 8 orë | 18 % |
| **5.** | Vendet e Ballkanit. | 3 orë | 7 % |
| **6.** | Marrëdhëniet Ndërkombëtare. | 1 orë | 2 % |
| **7.** | Lufta e Dytë Botërore. | 3 orë | 7 % |
| **8.** | Marrëdhëniet ndërkombëtare. Riorganizimet politike pas luftës. | 2 orë | 5 % |
| **9.** | Demokracitë Perëndimore. Konsolidimi i demokracisë dhe lulëzimi ekonomik në vitet 1945 – 1974. | 9 orë | 20 % |
| **10.** | Kriza e mesit të viteve 1970. Neoliberalizimi e Neokonservatorizmi. | 4 orë | 9 % |
| **11.** | Blloku komunist, dështimi i komunizmit. | 3 orë | 7 % |
| **12.** | Vendet Ballkanike. | 2 orë | 5 % |
| **13.** | Mbarimi i Luftës së Ftohtë. Problemet e sotme globale. | 1 orë | 2 % |
| | **Totali** | **44 ore** | **100 %** |

**Historia e Popullit Shqiptar ( Historia 4. Profili Shoqëror )**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1.** | Historia e Lashtë | 3 ore | 3 % |
| **2.** | Historia e mesjetës. Shqipëria në Perandorinë Bizantine ( 395 – shek. XIV ) | 5 orë | 6 % |
| **3.** | Shqipëria në Perandorinë Osmane ( shek. XIV - XVIII ). Lufta Shqiptare Osmane e shek. XV. | 5 orë | 6 % |
| **4.** | Historia e RE ( 1506 – 1912 ). Vendosja e plotë e sundimit Osman në tokat Shqiptare( shek XVI – XVIII ). | 2 orë | 2 % |
| **5.** | Pashallëqet e Mëdha Shqiptare. | 3 orë | 3 % |
| **6.** | Kultura dhe fetë në Shqipëri. | 1 orë | 1 % |
| **7.** | Rilindja kombëtare Shqiptare (vitet 30 të shek. XIX – 1912 ) | 3 orë | 3 % |
| **8.** | Lidhja Shqiptare e Prizrenit ( 1878 – 1881 ) | 6 orë | 7 % |
| **9.** | Lëvizja kombëtare Shqiptare në vitet 1882 – 1908 . | 2 orë | 2 % |
| **10.** | Drejt Pavarësisë së Shqipërisë. ( 1908 – 1912 ) | 6 orë | 7 % |
| **11.** | Populli Shqiptar në vitet 1912 – 1939. Shteti Shqiptar në vitet 1912 – 1914. | 4 orë | 5 % |
| **12.** | Shteti Shqiptar dhe viset Shqiptare jashtë tij në vitet 1914 – 1920. | 4 orë | 5 % |
| **13.** | Shqiptarët në vitet 1920 – 1924. | 5 orë | 6 % |
| **14.** | Shteti Shqiptar në vitet 1925 – 1939. | 6 orë | 7 % |
| **15.** | Trojet Shqiptare jashtë kufijve shtetëror ( 1913 – 1941 ) | 1 orë | 1 % |
| **16.** | Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore ( 1939 – 1944 ) Shqipëria në periudhën e pushtimit Italian ( 1939 – 1944 ). | 5 orë | 6 % |
| **17.** | Shqipëria nën pushtimin Gjerman ( tetor 1943 – nëntor 1944 ) | 3 orë | 3 % |
| **18.** | Kosova dhe Viset e tjera Shqiptare në Luftën e Dytë Botërore ( 1941 – 1945 ) | 3 orë | 3 % |
| **19.** | Shteti Shqiptar në vitet e pas Luftës së Dytë botërore ( 1944 – 2000 ). Sistemi politik në Shqipëri në vitet 1944 – 1948 | 4 orë | 5 % |
| **20.** | Sistemi komunist në Shqipëri në vitet 1949 – 1960 | 3 orë | 3 % |
| **21.** | Shqipëria në vitet 1961 – 1980 | 5 orë | 6 % |
| **22.** | Shqipëria në periudhën pas komuniste(1991 – 2000) | 2 orë | 2 % |
| **23.** | Shqiptarët jashtë kufijve shtetëror ( 1945 – 2002 ) | 6 orë | 8 % |
| | **Totali** | **87 ore** | **100 %** |

## Përmbajtja e listuar sipas teksteve të Historisë :

| Nr | Kapitulli | Tema | Teksti |
|---|---|---|---|
| **1.** | **Lindja e Mesme e Lashtë**<br>**2orë** | 1. Qytetërimi në Mesopotami.<br>2. Qytetërimi Egjiptian. | **Historia 1**<br><br>**Historia e Lashtë Botërore** |
| **2.** | **Greqia e Lashtë**<br>**& Maqedonia**<br><br>**6orë** | 1. Fillimet e qytetërimit grek. (Mjedisi gjeografik në qytetërimin grek)<br>2. Athina.<br>3. Sparta. (Sparta, lokalizimi, veçoritë e zhvillimit ekonomik e shoqëor; Organizimi i qeverisjes. Ligjet e Likurgut)<br>4. Epoka e ndritur e demokracisë Athinase. (Reformat e Perikl;iut ; Kufizimet e demokracisë)<br>5. Mbretëria e Maqedonisë (Filipi II i Maqedonisë; Aleksandri dhe fushatat e tij në lindje)<br>6. Trashëgimia e Greqisë së Lashtë. (Kulltura helenistike) | |
| **3.** | **Roma e Lashtë**<br><br>**5orë** | 1. Republika Romake.<br>2. Rënia republikës romake.(Diktatura ushtarake. Fundi i republikës)<br>3. Krijimi i Perandorisë romake. (Epoka e Augustit; Pax Romana – Paqja Romake)<br>4. Rënia e Perandorisë Romake<br>5. Përhapja e Krishtërimit. (Rrethanat e përhapjes; Mësimet e Jezu Krishtit) | |
| **4.** | **Bota Mesjetare.**<br>**395-1000**<br><br>**4orë** | 1. Qytetërimi Bizantin.<br>2. Lindja dhe përhapja e islamizmit.<br>3. Mbretëritë Franke. (Franket, krijimi i mbretërisë)<br>4. Perandoria e Karlit të Madh | **Historia 1**<br><br>**Historia Botërore e Mesjetës** |
| **5.** | **Zhvillimi i monarkive në Evropë**<br>**1000-1492**<br><br>**3orë** | 1. Sistemi feudal dhe rendi ri shoqëror në Evropën Perëndimore. (Origjina dhe natyra e feudalizmit;Sistemi çifligar)<br>2. Pushteti mbretëror ne Angli.<br>3. Krijimi i monarkisë kombëtare në Francë. | |
| **6.** | **Perandoria osmane**<br>**1300 – 1500**<br>**1orë** | 1. Perandoria osmane 1300 – 1500 | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **7.** | **Shoqëria në fillimet e kohës moderne.**<br>**4 orë** | 1. Reformacioni.<br>2. Përhapja e protestantizmit.(Reforma në Angli; Protestantizmi)<br>3. Reformacioni katolik.<br>4. Zbulimet e mëdha gjeografike. | **Historia 2**<br><br>**Historia Moderne Botërore** |
| **8.** | **Konsolidimi i monarkive absolutiste. Fillimet e krizës në qeverisje.1500 – 1789**<br><br>**4orë** | 1. Monarkia absolute në Francë.(Politikat mbretërore; Synimet e Luigjit XIV në Evropë)<br>2. Rusia, Perandori e fuqishme. (Sundimtarët e mëdhenj rus; Katerina e Madhe)<br>3. Konflikti Mbret-Parlament në Angli.<br>4. Triumfi i parlamentit në Angli. | |
| **9.** | **Ndryshime në jetën ekonomike dhe sociale shek. XVII – XVIII**<br>**1 orë** | 1. Revolucioni i parë industria (Anglia – atdheu u revolucionit;Hedhja bazave të kapitalizmit. Teoritë e reja ekonomike). | |
| **10.** | **Idetë e reja dhe kombet e reja**<br><br>**5orë** | 1. Iluminizmi.(Pikëpamjet e reja shkencore;Iluministët)<br>2. Krijimi i SHBA.<br>3. Revolucioni francez. Përmbysja e regjimit absolut.<br>4. Faza radikale e revolucionit.<br>5. Epoka e Napoleonit. | |
| **11.** | **Reaksioni dhe progresi në vitet 1815 – 1850**<br>**2orë** | 1. Kongresi i Vienës , triumfi i konservatorizmit.<br>2. Sfidat ndaj konservatorizmit.(Platformat e reja ideore;Reformat në Britani) | |
| **12.** | **Nacionalizmi dhe konsolidimi i komb - shteteve. Epoka e nacionalizmit**<br>**1850 – 1871**<br>**3orë** | 1. Bashkimi i Italisë.<br>2. Bashkimi i Gjermanisë.<br>3. Lufta civile dhe konsolidimi i SHBA. (Problemi i skllavërisë; Lufta civile dhe forcimi i komb - shtetit) | |
| **13.** | **Fillimet e qeverisjes së demokracisë liberale.**<br>**(1871 – 1900)**<br>**2 orë** | 1. Zhvillimet politike në Britaninë e madhe.<br>2. Franca – Republika e tretë. | |
| **14.** | **Qytetërimi në pragun e shekullit të XX**<br>**1orë** | 1. Sfidat ndaj qeverisjes demokratike e liberale dhe kërcënimi i qëndrueshmërisë. | |
| **15.** | **Thellimi i krizës së shek.XX. Lufta e Parë Botërore.**<br>**1 orë** | 1. Fillimi i Luftës së Parë Botërore. | **Historia 3 Profili shoqëror** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **16.** | **Traktatet e Paqes. Problemet e pazgjidhura. Prirjet e zhvillimit.**<br><br>**3 orë** | 1. Konferenca e Paqes në Paris.<br>2. Rrjedhojat e luftës së parë botërore.(Lidhja e Kombeve; Rrjedhojat e Luftës I Botërore)<br>3. Prirjet kryesore të zhvillimeve gjatë viteve 1918 – 1939. | **Historia Botërore e Shekullit të XX** |
| **17.** | **Demokracitë Perëndimore në vitet 1918 – 1938.**<br><br>**4 orë** | 1. SHBA në vitet 1920.<br>2. Kursi i ri i Rusveltit. (Thelbi i kursit të ri; Zbatimi i Kursit të RI)<br>3. Britania e madhe në vitet 1918 – 1939.(Gjendja pas Luftës I Botërore; Vitet e krizës)<br>4. Franca në vitet 1918 – 1938. | |
| **18.** | **Totalitarizmi komunist dhe fashist.**<br><br>**8 orë** | 1. Përmbysja e Carizmit. Mos konsolidimi i demokracisë.<br>2. Shteti totalitar komunist në periudhën 1918 – 1924 .<br>3. Vendosja e plotë e totalitarizmit komunist.(Totalitarizmi ekonomik stalinian)<br>4. Italia gjatë vit. 1918 – 1928 Vendosja e fashizmit.<br>5. Republika e Vajmarit.<br>6. Gjermania në rrugën e vendosjes së nazizmit.<br>7. Spanja në vitet 1918 – 1939 .<br>8. Regjimet diktatoriale në vendet e tjera të Evropës.(Kalimi në regjime diktatoriale) | |
| **19.** | **Vendet e Ballkanit.**<br><br>**3 orë** | 1. Jugosllavia në vitet 1918 – 1939 . (Formimi i Mbretërisë serbo – kroate – sllovene. Vendosja e hegjemonisë serbomadhe; Çështja nacionale)<br>2. Greqia në vitet 1918 – 1939 .<br>3. Revolucioni kombëtar Turk. Republika Turke. | |
| **20.** | **Marrëdhëniet ndërkombëtare.**<br>**1 orë** | 1. Marrëdhëniet ndërkombëtare në prag të Luftës së dytë Botërore. | |
| **21.** | **Lufta e Dytë Botërore**<br><br>**3 orë** | 1. Vitet e triumfit fashist.<br>2. Sulmi kundër Bashkimit Sovjetik. Fillimi i Luftës dhe Zhvillimi i saj.<br>3. Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **22.** | **Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Riorganizimet politike pas luftës**<br>**2 orë** | 1. Përpjekjet për konsolidimin e paqes.<br>2. Fillimi i Luftës së Ftohtë.(Përmbajtja dhe fillimi i Luftës së Ftohtë; Zhvillimi i Luftës së Ftohtë) | |
| **23.** | **Demokracitë Perëndimore. Konsolidimi i demokracisë dhe lulëzimi ekonomik. 1945 – 1974**<br>**9 orë** | 1. Rindërtimi ekonomik.(Plani Martshall)<br>2. Riorganizimi politik.(Masat për konsolidimin e demokracisë liberale)<br>3. Politika të liberalizmit modern.(Liberalizmi modern. Përmbajtja; Triumfi i shtetit të mirëqënies)<br>4. Hapat në integrimin Evropian.<br>5. Britania e Madhe.(Qeveria laburiste 1945 – 1951; Qeveria konservatore 1951 - 1964)<br>6. Franca.(Paqëndrueshmëria qeveritare; Republika V)<br>7. Republika Federale Gjermane.<br>8. Italia.(Ndryshimet në formën e qeverisjes; Tiparet e jetës politike)<br>9. SHBA në vitet 1945 – 1975 . | |
| **24.** | **Kriza e mesit të viteve 1970. Neoliberalizmi dhe neokonservatorizmi.**<br>**4 orë** | 1. Theçerizmi.<br>2. Reganizmi.<br>3. Alternativat e reja gjatë viteve 1990.<br>4. Hapa të tjerë në rrugën e integrimit Evropian. | |
| **25.** | **Blloku Komunist. Dështimi i Komunizmit.**<br>**3 orë** | 1. Bashkimi Sovjetik gjatë viteve 1945 – 1964.<br>2. Shndërrimet në Bashkimin Sovjetik.<br>3. Revolucionet e vitit 1989 në Evropën Lindore. | |
| **26.** | **Vendet Ballkanike.**<br>**2 orë** | 1. Shpërbërja e Jugosllavisë.<br>2. Bashkëpunimi Ndërballkanik. Pakti i Stabilitetit. | |
| **27.** | **Mbarimi i Luftës së Ftohtë. Problemet e sotme globale.**<br>**1 orë** | 1. Vazhdimësia dhe fundi i Luftës së Ftohtë. | |
| **28.** | **Historia e Lashtë**<br>**3 ore** | 1. Ilirët.<br>2. Shtetet Ilire në fillimet e tyre.<br>3. Shteti Ilir në shek. III – II para erës së re. | **Historia 4**<br>**Profili shoqëror** |
| **29.** | **Historia e mesjetës.** | 1. Shqiptarët në shekujt e parë të | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **Shqipëria në Perandorinë Bizantine ( 395 – shek. XIV )**<br><br>**5 orë** | mesjetës.<br>2. Shqiptarët pasardhës së Ilirëve.<br>3. Lindja dhe zhvillimi i marrëdhënieve feudale në Shqipëri. ( shek. VIII – XV ) (Veçoritë e lindjes së mardhënieve feudale; Struktura shoqërore dhe drejtimi i qyteteve)<br>4. Principata e Arbrit dhe Despotati i Artës.<br>5. Principatat Shqiptare të shek. XIV – një fazë e re në traditën Shqiptare. | **Historia e Popullit Shqiptar** |
| **30.** | **Shqipëria në Perandorinë Osmane (shek. XIV – XVIII) Lufta Shqiptare Osmane e shek. XV.**<br><br>**5 orë** | 1. Kryengritja e përgjithshme nën Skënderbeun. Lidhja e Lezhës.<br>2. Fitoret e Lidhjes Shqiptare të Lezhës<br>3. Formimi i shtetit të pavarur Shqiptar të Skënderbeut.<br>4. Betejat e viteve 50-60 shek XV, nën Skënderbeun.(Rrethimi II i Krujës 1466; Rrethimi III i Krujës 1467)<br>5. Rëndësia e epokës së Skënderbeut. | |
| **31.** | **Historia e RE ( 1506 – 1912 ). Vendosja e plotë e sundimit Osman në tokat Shqiptare ( shek XVI – XVIII ).**<br>**2 orë** | 1. Veçoritë e zbatimit të regjimit feudal ushtarak në qytetet Shqiptare.(Administrimi osman)<br>2. Veçoritë e zbatimit të regjimit feudal ushtarak në fshatin Shqiptar. | |
| **32.** | **Pashallëqet e Mëdha Shqiptare.**<br><br>**3 orë** | 1. Pashallëqet në Shqipërinë e Veriut.<br>2. Pashallëqet në Shqipërinë e Jugut. (Krijimi i Pashallëkut të Janinës; Zgjerimi i Pashallëkut)<br>3. Konflikti i Shqiptarëve me Stambollin. | |
| **33.** | **Kultura dhe fetë në Shqipëri.**<br>**1 orë** | 1. Kultura shqiptare (shek. XVI – ’20 të shek. XIX) | |
| **34.** | **Rilindja kombëtare Shqiptare (vitet 30 të shek. XIX – 1912 )**<br><br>**3 orë** | 1. Kryengritja kundër osmane dhe fillimet e Rilindjes Kombëtare. (Rilindja kombëtare dhe fazat e saj; Reformat e viteve ’30 të shekullit XIX)<br>2. Kryengritjet e Tanzimatit.<br>3. Lëvizja ideore, arsimore, dhe kulturore në etapën e parë të rilindjes kombëtare. | |
| **35.** | **Lidhja Shqiptare e Prizrenit** | 1. Kriza Lindore dhe Shqiptarët.( Marrëveshja e fshehtë austro – ruse | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **( 1878 – 1881 )**<br><br>**6 orë** | e Budapestit; Copëtimi i tokave shqiptare sipas traktatit të Shën Stefanit; Organizimi i lëvizjes kombëtare shqiptare)<br>2. Themelimi i Lidhjes së Prizrenit.<br>3. Platforma e Lidhjes së Prizrenit.<br>4. Lidhja e Prizrenit në mbrojtje të tërësisë së trojeve Shqiptare.<br>5. Qeveria e Lidhjes së Prizrenit.<br>6. Veprimtaria kulturore në periudhën e lidhjes Shqiptare.(Alfabeti shqip i Stambollit; Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip) | |
| **36.** | **Lëvizja kombëtare Shqiptare në vitet 1882 – 1908 .**<br>**2 orë** | 1. Arsimi dhe kultura.<br>2. Lidhja e Pejës. (Lidhja e Pejës; Kuvendi i Dibrës) | |
| **37.** | **Drejt Pavarësisë së Shqipërisë. ( 1908 – 1912 )**<br><br>**6 orë** | 1. Shqiptarët dhe Turqit e Rinj.(Shqiptarët dhe lëvizja xhonturke; Kuvendi i Ferizajt dhe rivendosja e kushtetutës)<br>2. Zgjerimi i veprimtarisë arsimore dhe kulturore Brenda vendit.<br>3. Lëvizjet kryengritëse në vitet 1909 – 1910 .(Përballimi i reaksionit xhonturk; Fillimi dhe përmasat e kryengritjes së Kosovës; Mësimet e kryengritjes.)<br>4. Kryengritja e Malësisë e vitit 1911.<br>5. Kryengritja e përgjithshme e viti 1912.<br>6. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. | |
| **38.** | **Populli Shqiptar në vitet 1912 – 1939. Shteti Shqiptar në vitet 1912 – 1914.**<br><br>**4 orë** | 1. Shteti i Pavarur Shqiptar dhe qeveria e Vlorës.<br>2. Njohja e Pavarësisë. Copëtimi i trojeve Shqiptare.<br>3. Shqipëria në regjimin e Princ Vidit.<br>4. Gjendja politike e shoqërore në Shqipëri në regjimin e Vidit. | |
| **39.** | **Shteti Shqiptar dhe viset Shqiptare jashtë tij në vitet 1914 – 1920.**<br><br>**4 orë** | 1. Shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore. (Traktati i fshehtë i Londrës; )<br>2. Lëvizja Kombëtare Shqiptare.(Programi politik i Lëvizjes kombëtare; Krahina autonome e Korçës.) | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | 3. Kongresi i Durrësit dhe Konferenca e Paqes në Paris.<br>4. Kongresi Kombëtar i Lushnjes. | |
| **40.** | **Shqiptarët në vitet 1920 – 1924.**<br><br>**5 orë** | 1. Qeveria e Tiranës për çlirimin e krahinave të pushtuara.<br>2. Shqipëria në arenën ndërkombëtare.<br>3. Përpjekjet për organizimin dhe demokratizimin e shtetit shqiptar.<br>4. Gjendja ekonomike dhe zhvillimet politike në Shqipëri në vitet 1920 – 1924 .<br>5. Revolucioni i Qershorit i vitit 1924. | |
| **41.** | **Shteti Shqiptar në vitet 1925 – 1939.**<br><br>**6 orë** | 1. Republika Shqiptare ( 1925 – 1928 ).<br>2. Marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës Shqiptare.<br>3. Mbretëria Shqiptare (1928 – 1939 ).<br>4. Ekonomia Shqiptare në vitet 1929 – 1939.<br>5. Politika e jashtme e shtetit shqiptar ( 1928 – 1939 )<br>6. Lëvizjet politike shoqërore ( 1928 – 1939 ). | |
| **42.** | **Trojet Shqiptare jashtë kufijve shtetëror ( 1913 – 1941 )**<br>**1 orë** | 1. Kosova dhe Çamëria pas vendimeve të Konferencës së Londrës.( 1912 – 1915 ) | |
| **43.** | **Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore. 1939 – 1944. Shqipëria në periudhën e pushtimit Italian (1939 – 1944)**<br><br>**5 orë** | 1. Agresioni fashist Italian dhe qëndresa popullore.<br>2. Regjimi i pushtimit Italian në fillimet e lëvizjes antifashiste.<br>3. Organizimi i popullit Shqiptar në luftën kundër pushtimit fashist.<br>4. Rritja e luftës antifashiste në kryengritje të përgjithshme.(Forcimi i shtabit të përgjithshëm. Organizimi i ushtrisë Nacionalçlirimtare;)<br>5. Marrëdhëniet ndërmjet forcave politike shqiptare në vitet 1942 – 1943. | |
| **44.** | **Shqipëria nën pushtimin Gjerman ( tetor 1943 – nëntor 1944 )** | 1. Pushtimi Gjerman i Shqipërisë. (Agresioni gjerman në Shqipëri dhe vendosja e regjimit nazist të pushtimit; Qëndrimi i forcave | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **3 orë** | nacionaliste ndaj pushtuesit gjerman. Krijimi i legalitetit)<br>2. Lufta për çlirimin e plotë të vendit.(Kongresi i Përmetit)<br>3. Çlirimi i Shqipërisë.( Kapitullimi i Italisë dhe përballja me pushtuesit gjerman; Lidhja e Dytë e Prizrenit; Konferenca e Bujanit dhe formimi i brigadave partizane.) | |
| **45.** | **Kosova dhe Viset e tjera Shqiptare në Luftën e Dytë Botërore ( 1941 – 1945 )**<br><br>**3 orë** | 1. Pushtimi fashist i viseve Shqiptare në Jugosllavi dhe qëndresa<br>2. Lëvizja antifashiste në Kosovë dhe viset e tjera në vitet 1943 – 1944 .<br>3. Çamëria në vitet e Luftës së Dytë Botërore. | |
| **46.** | **Shteti Shqiptar në vitet e pas Luftës së Dytë botërore ( 1944 – 2000 ). Sistemi politik në Shqipëri në vitet 1944 – 1948**<br>**4 orë** | 1. Vendosja e regjimit komunist.<br>2. Rimëkëmbja e vendit dhe reformat sociale dhe ekonomike.<br>3. Rezistenca kundër komuniste në Shqipëri.<br>4. Pozita e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. | |
| **47.** | **Sistemi komunist në Shqipëri në vitet 1949 – 1960**<br><br>**3 orë** | 1. Lufta e klasave dhe dënimet politike.<br>2. Thellimi i reformave komuniste. Industrializimi i vendit. (Industria dhe tiparet e saj; Sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit; Kolektivizimi i pronës në fshat)<br>3. Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare 1949 – 1960 . | |
| **48.** | **Shqipëria në vitet 1961 – 1980**<br><br>**5 orë** | 1. Politika e jashtme e qeverisë Shqiptare në vitet 1961 – 1980.<br>2. Arsimi, kultura, dhe feja në vitet 1967 – 1970.<br>3. Ashpërsimi i luftës së klasave në vitet 1970.<br>4. Kriza ekonomike, politike dhe sociale në Shqipëri në vitet 1981 – 1990 .<br>5. Lëvizja komuniste dhe shpallja e pluralizmit politik. | |
| **49.** | **Shqipëria në periudhën pas komuniste ( 1991 – 2000 )**<br>**2 orë** | 1. Ndryshimet demokratike në Shqipëri në vitet 1991–2000<br>2. Shqipëria në rrugën e integrimit euroatlantik. | |
| **50.** | **Shqiptarët jashtë kufijve** | 1. Kosova dhe Çamëria në vitet 1945 | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **shtetëror ( 1945 – 2002 )**<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>**6 orë** | – 1948 . (Aneksimi i Kosovës nga Serbia;Statusi juridik, politik dhe ekonomik i shqiptarëve të Kosovës; Shteti shqiptar dhe çështja çame)<br>2. Kosova dhe viset e tjera Shqiptare në Jugosllavi. ( 1949 – 1966 ).<br>3. Forcimi i autonomisë. Kushtetuta e Kosovës e vitit 1974.<br>4. Rrënimi i autonomisë në Kosovë dhe kufizimi i të drejtave të Shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi ( 1981 – 1990 ).<br>5. Lëvizja kombëtare demokratike në Kosovë në fund të viteve 1980. (Krijimi i partive politike në Kosovë; Kushtetuta e Republikës së Kosovës, shtator 1990)<br>6. Kosova dhe viset e tjera shqiptare në ish Jugosllavi në vitet 1990. | |

**Shënim:** ***Për tema mësimore të caktuara, përbri temës janë dhënë në kllapa ato çështje mësimore të cilat nxënësi duhet të studiojë.***

**Historia e Lashtë Botërore dhe e Mesjetës. Historia 1** ( për arsimin e mesëm të profilizuar ). Autorë: Roland Gjini, Loreta Terihati, Moikom Zeqo, Ilira N.Sulo. Botimi 1999.
Ribotimi 2003.
**Historia moderne Botërore. Historia 2** ( për arsimin e mesëm të profilizuar ). Autorë: Llambro Filo, Petrika Thëngjilli, Ilira N.Sulo, Moikom Zeqo, Romeo Gurakuqi. Botimi 2000. Ribotim 2007.
**Historia Botërore e Shekullit të XX. Historia 3. Profili shoqëror.** ( per arsimin e mesëm të profilizuar ) Autorë: Llambro Filo, Ilira N.Sulo , Gëzim Sala, Moikom Zeqo, Pranvera Dibra, Loreta Terihati. Botimi 2001. Ribotimi 2006.
**Historia e Popullit Shqiptar. Historia 4. Profili shoqëror.** (për arsimin e meseëm të profilizuar ). Autorë: Myzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli,Gazmend Shpuza, Fatmira Rama, Xhelal Gjeçovi, Dilaver Sadikaj, Ana Lalaj. Botimi 2006.

**Shënim : Tekstet Historia 1 & Historia 2 janë të njëjta si për profilin shoqëror ashtu dhe për profilin natyror .**
**Tekstet Historia 3 & Historia 4 i përkasin profilit shoqëror.**